



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:249281
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05619581

Ac.nr.10024/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B..... P....., nga fshati Dragobil, Komuna e Malishevës, përfaqësuar me autorizim nga R..... K....., avokat në Prishtinë, rruga L..... H....., numër 104, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, përfaqësuar me autorizim nga B..... M....., me objekt të kontestit shpërblimin e dëmit jomaterial për shkak të heqjes së lirisë pa bazë, me vlerë të objektit të kontestit në shume prej 75,000.00€ (tetëmijetëqindinjëzet euro), duke vendosur sipas ankesës së palëve ndërgjyqëse të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3752/18, të datës 28.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa themelta ankesat e paditësit B..... P....., nga fshati Dragobil, Komuna e Malishevës dhe e të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3752/18, i datës 28.09.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.3752/18, të datës 28.09.2021 ka vendosur në këtë mënyrë: **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.... P....., nga fshati Dragobil, Komuna e Malishevës, dhe **DETYROHET** e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, të nderit dhe të lirive, për shkak të caktimit të masës së paraburgimit prej datës 23.09.20211 e deri me 16.02.2012, gjithsejtë 147 ditë, t’ia paguaj shumën prej 8,820.00€ (tetëmijetëqindinjëzet euro), me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e dhënies së këtij aktgjykimi (28.09.2021), e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm. **REFUZOHET** si e pathemeltë kërkesëpadia e

paditësit, mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në shumë prej 66,180.00€ (gjashtëdhjetegjashtëmijë e njëqindetëdhjetë euro). DETYROHET e paditura që paditësit, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumën prej 679.60€ (gjashtëqindeshtatëdhjetenëntë euro e gjashtëdhjetë euro/cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij Aktgjykimit brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar paditësi për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të aprovohen shumat e kërkuara.

Kundër këtij Aktgjykimit brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar e paditura, për shka të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, që Aktgjykimi i atakuar të priset dhe të kthehet lëna në rigjykim dhe rivendosje, apo ta ndryshoj dhe paditësit t'ia njuhë të drejtën e kompensimit konform kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 04/2015.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesat e palëve ndërgjyqëse janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 19.12.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës për shkak të kompensimit të dëmit jo material.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se nga provat e administruara dhe nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, rezultoi se nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qëndruar nën masën paraburgimit për 147 ditë, pra nga palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadiës. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e kërkesëpadiës e kërkuar nga paditësi. Nga provat e administruara në shqyrtimin kryesor të çështjes rezulton se paditësit me aktvendimin Hep.nr.179/2011, të datës 23.09.2011, nën dyshimin se ka kryer veprat penale dhe atë: rrembi i personit në bashkëkryerje nga neni 159 par 2 lidhur me par1, e në lidhje me nenin 23 të KPRK-së, privimin e kundërligjshëm nga liria në bashkëkryerje me nenin 162 par 2 lidhur me par 1 e në lidhje me nenin 23 të KPRK-së, marrje e pengjeve në bashkëkryerje nga neni 143 par 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtje në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPRK-së, i është caktuar masa e paraburgimit për sigurimin e të pandehurit në procedurën penale në kohëzgjatje prej 174 ditëve, duke filluar nga nata 23.09.2011 e deri me datën 16.02.2012. Nga ana e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, është ngritur aktakuza PP.nr.250/11/2014 e datës 05.04.2012 dhe PP.nr.117/2012 të datës 13.07.2012, duke e akuzuar këtu paditësin për veprat penale të cekura si më lartë. Duke vendosur sipas aktakuzës së lartcekura Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin P.nr.124/2012, të datës 09.06.2017,

të pandehurin B..... P....., këtu paditësin e ka refuzuar akuzën për veprat penale të cekura si më lartë. Kundër këtij aktgjykimi është ushtruar ankesë nga Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, e cila me aktgjykimin PAKR.nr.583/2017, të datës 15.01.2018, ka vendosur që të refuzohet ankesa e Prokurorisë sa i përket vendimit për këtu paditësin dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në tërësi. Meqenëse paditësi ka qëndruar nën masën e paraburgimit për 147 ditë, përmes të autorizuarit të tij iu ka drejtuar me kërkesë të paditurit Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjegjësisht Komisionit për kompensim dëmi personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, për kompensim dëmi material. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjegjësisht Komisionit për kompensim dëmi personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pabazë nga liria, me paditësen kishin negociuar ujdi jashtëgjyqësore dhe i kishte ofruar marrëveshje për kompensim të dëmit material, ndërsa me datë 29.10.2018 të njëjtin e kishin arritur ujdi jashtëgjyqësore, duke i ofruar paditësit shumën prej 1,693.00€. Në këtë marrëveshje nuk është përfshirë kompensimi i dëmit jomaterial, pasi që paditësi ka deklaruar se lidhur me këtë kërkesë do ti drejtohet gjykatës kompetente. Gjykata për të vërtetuar intensitetin e dhimbjeve shpirtërore, shqetësimeve dhe frikës që mund të ketë pësuar paditësi, si pasojë e qëndrimit në paraburgim, ka nxjerrë provën me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë, të punuar nga Dr. N..... M....., psikiatër. E njëjta në mendimin e saj, ka konstatuar se në periudhën e qëndrimit në paraburgim dhe atë nga data 23.09.2011 e deri me datë 16.02.2012, paditësi ka përjetuar vuajtje dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë, sidomos në rastin e arrestimit dhe lajmërimit të të njëjtit në media duke i cekur emrin dhe mbiemrin, gjendja emocionale e këtu paditësit si pasojë e arrestimit, mbajtjes në paraburgim, deri te përfundimi i tërësishëm i procesit gjyqësor, kur edhe është shpallur i pafajshëm dhe është refuzuar aktakuza. Në momentin e lirimit nga paraburgimi tek paditësi janë manifestuar edhe më tej dhimbje dhe vuajtje shpirtërore të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 6 muaj, periudhë kjo e paraqitjes së detyruar në stacionin policor çdo javë, më pastaj ankthi dhe stresi për shkak të vënies në barrë të një veprë të rëndë, brengës për ecurinë e procesit duke reflektuar dhe ndikuar negativisht në jetën e tij personale. Dhimbjet shpirtërore kanë vazhduar edhe më tej por me intensitet më të ulët deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe me aktgjykimin lirues nga akuza. Ndërsa sa i përket frikës së përjetuar me rastin e arrestimit dhe qëndrimit në paraburgim ka theksuar se paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 3 ditë, gjendje e reagimit akut me stres dhe ankthe intensive sidomos gjatë natës, shoqëruar me pagjumësi dhe vështirësi të adaptimit në kushtet penale. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 1 muaj, periudhë kjo e shoqëruar me brenga të vazhdueshme për të ardhmen e tij, dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka qenë prezent deri në momentin e lirimit nga paraburgimi dhe ka vazhduar të paraqitet edhe më tej herë pas here. Së këndejmi, për këtë kategori të dëmit është caktuar shpërblimin në lartësi prej 8,820.00€. Gjykata ekspertizën mjekësore të psikiatrisë, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve në këtë çështje kontestimore. Shpërblimin e dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë, si dhe frikës së përjetuar, gjykata u mbështet në mendimin profesional të dhënë nga eksperti psikiatër, i cili sipas vlerësimit të gjykatës në mënyrë profesionale ka konstatuar se paditësi gjatë kohës së qëndrimit nën masën e paraburgimit, ka përjetuar simptoma të stresit, ankthe intensive, pagjumësi, reagime emocionale. Gjykata vlerëson se shumata e

gjykuara për paditësin paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar nga ai gjatë kohës së qëndrimit nën masën e paraburgimit, dhimbjet shpirtërore të përjetuara nga paditësi, e të cilat gjykata i caktoi sipas bindjes së lirë konform nenit 183 të LMD-së, si dhe duke pasur si orientim kriteret dhe masat e vëna nga praktika gjyqësore lidhur me lartësinë e dëmeve jo materiale, posaçërisht lidhur shpërblimet e kësaj natyre. Po ashtu me rastin e vendosjes për vlerën e shpërblimit ka marrë parasysh edhe rrethanat tjera që janë ndikuar, siç janë kohëzgjatja e qëndrimit nën masën e paraburgimit, natyra e veprës për të cilën ka qenë akuzuar, moshën e paditësit dhe rrethanat familjare të tij, patën ndikim në vendosjen e shumave si në dispozitiv. E drejta e kompensimit të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye rregullohet sipas Udhëzimit Administrative nr. 04/2015, të datës 04.11.2015, i cili në nenin 12 paragrafi 2 përcaktohet se për dëmin jo material/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës dhe turpfit, personi i dënuar ose të arrestuar sipas bazës së arrestit shtëpiak, kompensohet në shumën prej gjashtë (6) euro në ditë. Gjithashtu, me neni 529 të KPPRK-së, përcaktohet se e drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu edhe personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar. Gjykata gjithashtu aplikoi dispozitën e nenit 136 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, sipas së cilës dispozitë përcaktohet se kush i shkakton dëm tjetrit është i detyruar t'ia kompensoj për deri sa të mos provoj se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, andaj gjykata konsideron se e paditura në rastin konkret duhet ta shpërblej demin e shkaktuar paditësit me caktimin e masës së paraburgimit pa drejtë, që me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza. Kurse për sa i përket kategorisë së shpërblimit të dëmit jo material gjykata ka aplikuar nenin 183 par. 1 të LMD, sipas të cilit për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Kurse në paragrafin 2 të këtij neni parashihet me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror. Për efekt të natyrës së kësaj çështje juridike, kjo gjykatë vlerëson se ky aktgjykim është në pajtim me instrumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut e që janë të zbatueshme edhe në Republikën e Kosovës, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës. Kështu, me nenin 5 paragrafi 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin në vijim do të përdoret vetëm emri: Konventa), është përcaktuar se çdo person që ka rënë viktimë e një arrestimi ose ndalimi në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtë për dëmshpërblim. Lidhur me këtë, kjo gjykatë mban në vëmendje edhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim do të përdoret shkurtesa: GJEDNJ), e cila në jurisprudencën e saj në çështjen V..... and B..... v. Russia lidhur me kompensimin e personave të dënuar pa arsye, ka shprehur qëndrim se detyra e vlerësimit të dëmit që duhet dhënë personit si kompensim është e vështirë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast kur janë në shprehje të drejtat personale, si dhe vuajtja, çoftë fizike apo mendore, është objekt i kërkesës për

kompensim. Krahas kësaj në këtë vendim është theksuar se nuk ka ndonjë standard me të cilën dhimbjet shpirtërore, shqetësimi psikologjik dhe ankthi mund të maten në një kundërvlerë të saktësisht të matshme të parave. Përveç kësaj, GJEDNJ përmes këtij vendimi ka thënë se vlerësimi nga ana e gjykatave i shumave të matshme të kompensimit, duhet të bëhet duke u bazuar në kritere të qëndrueshme të cilat duhet të marrin parasysh standardin e jetës të vendit. Sido që të jetë, Gjykata Evropiane ka theksuar se nuk mund të lejohet një shumë tejet e ulët e kompensimit, e cila do të ishte aq e ulët saqë do të minonte frymën e vërtetë të nenit 5.5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ngase do të humbiste thelbin e zbatueshmërisë së këtij neni, i cili garanton të drejtën e kompensimit të personave të dënuar apo paraburgosur pa arsye (shih çështjen V..... and B..... v. Russia, [52241/14](#) dhe [74222/14](#)). Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit në bazë të nenit 382 par. 2 të LMD, duke gjykuar kamatën për dëmin jo material nga dita e dhënies së këtij aktgjykimi me datë 28.09.2021. Gjykata vendosi si në dispozitiv e II të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë përtej shumave të gjykuara, dhe atë për kompenson dëmin jo material dhe atë për shkak të përjetimeve të të gjitha formave të dhimbjeve dhe vuajtjeve shpirtërore dhe gjitha format e frikës shumë prej 66,180.00€, ngase vlerësoi se shpërblimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që shpërblimi të ishte i drejtë, e po ashtu shuma e shpërblimit që është ndërtuar nga praktika gjyqësore. I autorizuari i palës paditëse në precizimin e kërkesëpadisë i ka bërë ndarjen si kategori të veçantë të dëmit për dhimbjet dhe vuajtjeve shpirtërore dhe format e frikës, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se nuk mund të gjykohej si kategori të veçanta dëmi për dhimbjet shpirtërore dhe dëmi për të gjitha format e frikës, pa qenë më janë të ndërlidhura me një kategori dëmi, në rastin konkret dëmi për dhimbjet shpirtërore dhe dëmi për të gjitha format e frikës për shkak të cenimit të autoritetit, prestigjit etj. Prandaj janë gjykuar shumat si në dispozitiv në emër të dhimbjeve shpirtërore dhe frikës për shkak të cenimit të autoritetit, prestigjit, nderit, lirisë. Ky vlerësim i gjykatës, është në përputhje me nenin 183 par. 1 të LMD-së. Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerr konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së si dhe sipas tarifës zyrtare të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë: atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 €, për tri seanca shumë prej 405.60€, për ekspertizën e psikiatrisë shumë prej 150.00 €, për taksën gjyqësore shumë prej 20.00 €, në shumë të përgjithshme prej 679.60€, pasi që këto janë shpenzime proporcionale me suksesin e arritur në procesin gjyqësor dhe kanë qenë shpenzime të domosdoshme. Gjykata refuzoi kërkesën e palës paditëse për njohjen e shpenzimeve procedurale mbi shumë prej 679.60€, sepse në këtë çështje kemi të bëjmë me konteste me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në vlerën prej 10,000.00€.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as

shkeljeve të tjera nga neni 182.2 pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësin në raport me dëmin jo material, për shkak të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, frikës dhe dëmtimit të autoritetit për privim të paarsyeshëm nga liria për 147 ditë, duke vlerësuar se shumata e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material, janë në harmoni me kriteret e zbatueshme për vlerësim dhe me praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Republikës së Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe me natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit e pranon qëndrimin dhe përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket lartësisë së dëmshpërblimit të cilin në këtë rast ia ka gjykuar paditësit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, dhe vlerëson se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike dhe mospërfshirjes së aktgjykimit të atakuar me shkelje esenciale të procedurës në këtë pjesë të aktgjykimit dhe as në shkelje të tjera të pretenduara nga palët ndërgjyqëse, gjykata sa i përket lartësisë së kompensimit për paditësin, ka bërë zbatim të drejtë të së drejtës materiale, kur paditësit ia ka caktuar shumën prej 8,820.00 Euro në emër të shpërblimit të dëmit jo material, e cila shumë është në harmoni me praktikën e deritanishme gjyqësore, marrë parasysh raportin juridik dhe periudhën kur ka ndodhur arrestimi dhe privimi i kundërligjshëm i paditësit për 147 ditë.

Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e gjykuar për paditësin si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar është adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 par.2 të LMD-së, të zbatuar për këtë rast dhe se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që të dëmtuarit (në këtë rast paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me nenin 200 par.2 të LMD-së përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror“*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit dhe me dhimbjet e pësuar, ashtu që ky kompensim të përfaqësoj

një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar për shkak të privimit të pa arsyeshëm nga liria për 147 ditë, e në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë që është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Nisur nga fakti se një ditë burgimi është i pa kompensueshëm, gjykata vlerësoi se me shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, për se afërmi arrihet të kompensohet për dhimbjet e përjetuara të paditësit dhe me të arrihet ti ndihmoj paditësit që ti pranojë, si falje e gabimit të bërë nga organet përkatëse. Në nenin 154.1 të LMD-ës parashihet “*Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”, gjykata konsideron se i padituri në rastin konkret duhet ta korrigjojë dëmin e shkaktuar paditësit me paraburgim të kundërligjshëm, i cili me Aktgjykim të plotfuqishëm është refuzuar akuza ndaj tij.

Ky institut juridik njëjtë është rregulluar edhe me dispozitat e LMD-ës së vitit 1978 dhe me ato të LMD-ës Nr.04/ L-077.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjen mbështetje në nenin 200 të LMD-së, por edhe në nenin 5 paragrafi 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i cili shprehimisht përcakton se “*Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim*”.

Si rrjedhojë e kësaj, është vendosur që aktgjykimit i atakuar të vërtetohet, e të refuzohet si e pa bazuar ankesat e palëve ndërgjyqëse. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes lidhur me të drejtën materiale, me të drejtë është bazuar në dispozitat e LMD-ës.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është vërtetuar me pa mëdyshje detyrimi i të paditurit për kompensimin e dëmit material paditësit, bazuar në dispozitat e LMD-ës.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur kamatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenin 382 të LMD-ës.

Po ashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10024/2021, datë 24.04.2024

Kryetari i kolegjit,

Ardian Ajvazi